



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0105

PSH. nr. 0105/26

0123/26

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Batisha Ibrahim Anetare dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “Dio Bes” SH.P.K. dhe ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “Quality Asphalt” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi I rrugeve ne Bajgore, Rashan, Terstene, Kutllovc dhe Vllahi – Komuna e Mitrovices se Jugut ne bashkefinansim me MMPHI”, me numër të prokurimit: 642-25-5633-5-1-1 te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovices, me datën 27.03.2026, mori këtë:

Vendim

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa Operatorit Ekonomik “Dio Bes” SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 20.02.2026 me numër protokollit 0105/26, si dhe Aprovohet si e bazuar dhe ankesa e Operatorit Ekonomik “Quality Asphalt” SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 02.03.2026 me numër protokollit 0123/26 për aktivitetin e prokurimit me titull: Asfaltimi I rrugeve ne Bajgore, Rashan, Terstene, Kutllovc dhe Vllahi – Komuna e Mitrovices se Jugut ne bashkefinansim me MMPHI me nr. të prokurimit 642-25-5633-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovices.

II. Autoriteti Kontraktues - Komuna e Mitrovices të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit si dhe të kthehet në Rivlersim aktivitetin e prokurimit sipas pikës I të këtij dispozitivi .

III. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës së operatoreve ekonomik si dhe obligohen operatorët ekonomik ankesues “Dio Bes” SH.P.K. dhe “Quality Asphalt” SH.P.K. që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesën për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i

bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.06.2025, Komuna e Mitrovices në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Asfaltimi I rrugeve ne Bajgore, Rashan, Terstene, Kutllovc dhe Vllahi – Komuna e Mitrovices se Jugut ne bashkefinansim me MMPHI” me numër të prokurimit: 642-25-5633-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës Punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 3,290,666.00 €.

AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar aktiviteti e prokurimit ne fjale.

Me 16.02.2026, OE “Dio Bes” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me date 15.02.2026 po ashtu edhe OE “Quality Asphalt” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 19.02.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues

Me 20/02/2026, OE “Dio Bes” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0105/26. Ndërsa me datë 02/03/2026 OE “Quality Asphalt” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0123/26.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0105/26 dhe ankesa nr. 0123/26 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Dio Bes” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit, ku me datën 10.02.2026 ka ngritur në E-prokurim formularin B58. Fillimisht sqarojmë se autoriteti kontraktues ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-së dhe nenit 43 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr.001/2022 dhe Plotësimi dhe Ndryshimi Nr.002/2024.

Arsyeja pse është anuluar aktiviteti i prokurimit në kundërshtim me këto dispozita ka të bëjë edhe me faktin se dosja e tenderit është përgatitur nga vetë autoriteti kontraktues dhe, para se të përgatitej, janë zhvilluar edhe fazat e tjera procedurale, duke përfshirë kërkesën për iniciimin e aktivitetit të prokurimit nga njësia kërkuuese, e cila është përgjegjëse për hartimin e specifikave teknike lidhur me projektin në fjalë.

Bazuar në këtë, është përgatitur dhe publikuar dosja e tenderit, siç kërkohet në nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr.001/2022 dhe Plotësimi dhe Ndryshimi Nr.002/2024.

Në përputhje me dispozitat e lartpërmendura, është e qartë se dosja e tenderit është materiali themelor mbi bazën e të cilës përgatiten ofertat e operatorëve ekonomikë ofertues.

Neni 17.12 kërkon që në dosjen e tenderit autoriteti kontraktues të deklarojë të gjitha informacionet relevante për kontratën në fjalë, që operatorët ekonomikë të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informacion shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takimet para-tenderuese, etj. lidhur me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit duhet të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit duhet të përgatitet në mënyrë që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë.

Nga ana tjetër, Neni 17.7 i Rregullores për Prokurimin Publik Nr.001/2022 dhe Plotësimi dhe Ndryshimi Nr.002/2024 përcakton se:

"Formulari për dorëzimin e ofertës është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare."

Andaj, duke u bazuar në informatat e publikuara në dosjen e tenderit, të cilat lidhen drejtpërdrejt me projektin, operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre, pa pasur ndonjë vërejtje në përpilimin e dosjes së tenderit, përkatësisht në paramasë dhe parallogari, ku specifikohet qartë edhe fushëveprimi i kontratës.

Për më tepër, meqenëse në paramasë dhe parallogari përcaktohen qartë specifikat dhe përshkrimi i fushëveprimit të kontratës, autoriteti kontraktues ka qenë i detyruar që gjatë vlerësimit të marrë parasysh këtë fakt dhe ti respektojë këto kërkesa dhe dispozita ligjore, me qëllim që gjatë vlerësimit të ofertave ti marrë në konsideratë dhe ti vlerësojë ato sipas kërkesave dhe përshkrimeve në dosjen e tenderit, përkatësisht në paramasë.

Ne konsiderojmë se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik, sepse gjatë fazës së tenderimit janë shteruar të gjitha

mundësitë ligjore për përmirësim dhe korrigjim të dosjes së tenderit dhe, eventualisht, specifikave teknike. Prandaj, as njësia kërkuese as komisioni vlerësues nuk mund ta kthejnë këtë aktivitet në pikën zero, e aq më pak njësia kërkuese, e cila është edhe hartuese e specifikave dhe fushës së veprimtarisë së këtij projekti.

Për më tepër, ngritja e çështjes në fjalë dhe arsyeja e anulimit, e cekuara nga anëtari i komisionit vlerësues i cili është caktuar nga njësia kërkuese, është e pabazuar dhe tendencioze, për faktin se ky anëtar i komisionit vlerësues, tani në momentin e vlerësimit, kur kanë kaluar të gjitha fazat e sqarimeve eventuale, ka ngritur çështjen e mospërputhjes së paramasës me projektin e këtij tenderi. Prandaj, ky veprim i këtij anëtari për ne është tendencioz dhe e shohim me dyshime të mëdha për të diktuar këtë proces të prokurimit në koordinim me njësinë kërkuese, nga i cili departament vjen edhe ky anëtar i komisionit vlerësues. Sidomos kur kemi parasysh faktin se vetëm grupi ynë ofertues është i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, fakt që e kanë konstatuar edhe dy anëtarët e tjerë të komisionit vlerësues (kryetari dhe një anëtar i komisionit), me përjashtim të anëtarit që është propozuar nga njësia kërkuese. Me këtë rast, të gjithë ofertuesit tjerë janë të papërgjegjshëm, dhe këtë e ka konstatuar edhe komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues, me të cilin konstatim pajtohem edhe ne si operator ekonomik në drejtim të papërgjegjshmërisë së ofertave të operatorëve ekonomikë tjerë.

Lidhur me vlerësimin e ofertës tonë, vlerësimi dhe deklarimi i tre anëtarëve të komisionit vlerësues është bërë në këtë mënyrë:

Mbi këtë bazë, konsiderojmë se pretendimet dhe tendenca e ushtrimit të ndikimit nga anëtari i komisionit vlerësues i propozuar nga njësia kërkuese ka qenë tërësisht subjektiv në raport me ofertën tonë, duke ndikuar kështu edhe në rezultatin përfundimtar të këtij aktiviteti të prokurimit.

Ndërsa, sa i përket arsyeve të anulimit të tenderit për mospërputhjen e disa pozicioneve të paramasës me projektin, këto arsye dhe pretendime nga anëtari i komisionit, në këtë fazë, janë krejtësisht joprofesionale, kundërtënëse, subjektive, tendencioze dhe për më tepër, janë edhe joligjore, për shkak se asnjë projekt nuk mund të konsiderohet i "përsosur" gjatë përpilimit të tij. Çdo projekt mund të ketë mangësitë e veta, megjithatë për çdo mangësi eventuale gjatë implementimit të kontratës ekziston mundësia ligjore që të revidohen ose amandamentohen projektet në përputhje me rrethanat dhe në harmoni të plotë me legjislacionin për prokurim publik.

Për më tepër, përmirësimi i lëshimeve eventuale gjatë realizimit dhe implementimit të kontratës mund të bëhet me revidimin dhe amandamentimin e lëshimeve të mundshme të projektit, sepse kjo është e lejuar nga dispozitat e legjislacionit për prokurim, përkatësisht neni 71 i Rregullores për Prokurim Publik, i cili parashikon ndryshimet në kontratë gjatë realizimit dhe implementimit të projektit.

Si prova materiale, bashkëngjitur gjeni tre amandamente të kontratave, me të cilat dëshmohet se ndryshimet në projekt janë pjesë e pandashme e aktiviteteve ndërtimore. Dokumentet janë të emërtuara si: Prova 1, Prova 2 dhe Prova 3.

Prandaj, bazuar në sqarimet e mësipërme, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që ta detyrojë autoritetin kontraktues ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe të shpallë ofertën tonë fituese të kontratës, sepse jemi të vetmit të përgjegjshëm dhe plotësojmë të gjitha kërkesat dhe kushtet që autoriteti kontraktues i ka përcaktuar për këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu, kemi ofruar çmimin më të ulët dhe brenda vlerës së parashikuar, andaj ju sigurojmë se projekti do të

realizohet në mënyrën më të mirë, pasi jemi operator ekonomik i përgjegjshëm, me përvojë dhe kapacitet të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti dhe jo vetëm.

Gjithashtu, kjo për faktin se autoriteti kontraktues nuk ka dhënë sqarime dhe argumente konkrete për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke e shtrembëruar përmbajtjen e saj, pa dhënë arsye konkrete dhe pa marrë parasysh argumentet tona, të cilat kanë qenë mjaft të qarta dhe konkrete.

Përfundimisht, nga sqarimet e mësipërme, tashmë është e qartë se ne si grup i operatorëve ekonomikë të përgjegjshëm jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, si dhe anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe 43 të Rregullores për Prokurimin Publik. Për më tepër, anulimi i kësaj procedure dhe ritenderimi eventual dyfishon koston e shpenzimeve tona, si dhe rrit mundësinë e koston së shpenzimeve për autoritetin kontraktues, duke e ditur se çdo ditë ka lëvizje të çmimeve në treg.

Gjithsesi, autoriteti kontraktues duhet ta dijë se mbi të gjitha është parim ligjor që operatorët ekonomikë ofertues nuk duhet të pësojnë dëme për shkak të ndonjë lëshimi eventual teknik të autoritetit kontraktues, dhe sidomos në këtë rast, ku lëshimi teknik mund të korrigjohet shumë lehtë gjatë implementimit të kontratës. Prandaj, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që t'i marrë për bazë sqarimet tona, në përputhje me faktet dhe argumentet e paraqitura në ankesë, sepse mbi këtë bazë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar kushtet e nenit 60 të LPP-së dhe nenit 43 të Rregullores për Prokurimin Publik. Për më shumë, anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit në këtë fazë është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43.5 dhe 43.7 të Rregullores Nr.001/2022, pasi që nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita.

Neni 43.5 i Rregullores Nr.001/2022 ka parashikuar kushtet që duhet të plotësohen për anulim, si më poshtë:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: a. Asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; b. Asnjë prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; c. Numri i operatorëve ekonomikë të përgjegjshëm për kontratën publike me më shumë se një operator ekonomik është më pak se 3 (tre); d. Nuk ka kërkesa për të marrë pjesë në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; e. Numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/konkurruese me negociata është më pak se 3; f. Nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; g. Asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk është i përgjegjshëm; h. Nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; i. Një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet ose të parandalohet përmes një ndryshimi; j. Nëse autoriteti kontraktues gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim, me verifikim të KRPP-së, është i pariparueshëm; ose k. Nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë të paparashikuar dhe jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e paraqitura më lart, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që t'i marrë për bazë faktet tona të paraqitura në këtë ankesë, sepse autoriteti kontraktues duhet t'i respektojë dhe t'i ketë në konsideratë parimet e LPP-së, si dhe qëllimin e LPP-së. Nga ky veprim i autoritetit kontraktues në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në

nenin 1 të këtij ligji, ku shkruan qartë: "Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë."

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Quality Asphalt" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Me datë 10.02.2026, Autoriteti Kontraktues - Komuna Mitrovicë ka publikuar formularin B58 - Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe ka rekomanduar anulimin e kësaj procedure. Si pasojë, Operatori Ekonomik ankues, Quality Asphalt shpk, bazuar në nenin 108/A të LPP-së dhe në afatin e paraparë, ka paraqitur kundërshtimet për të njëjtin propozim dhe arsyetimin e anulimit të procedurës, ku AK ka potencuar si më poshtë:

ARSYETIMI PËR ANULIM
Autoriteti Kontraktues, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Pjesëmarrjen dhe Ndryshimin e Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, sipas nenit 43.5, Procedura e prokurimit, pas hapjes së ofertave, duhet të anulohet për një nga arsyet e përcaktuara, ku sipas pikës i) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi.

Andaj, duke qenë se procesi i vlerësimit nuk ka mundur të përfundojë në afatin e paraparë kohor për shkak të vonesave të papritura dhe situatave të justifikueshme, Autoriteti Kontraktues anulon procedurën e prokurimit si rezultat i një rishqyrtimi teknik të realizuar nga Njësia e Kërkesës në bashkëpunim me stafin inxhinierik dhe komisionin vlerësues, me arsyetimin nga ana e tyre se gjatë analizës së dokumentacionit teknik dhe përpilimit të projektit ekzistojnë mospërputhje të paramasës dhe projekteve ekzistuese.

Për këtë arsye dhe duke u bazuar në kërkesën e Njesisë së Kërkesës, si drejtoresha iniciuese për realizimin e projekteve, rekomandohet anulimi i aktivitetit aktual të prokurimit B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES dhe inicimi i një procedure të re tenderimi, vetëm pas harmonizimit të projekteve, me qëllim të sigurimit të një procesi të rregullt, të drejtë dhe teknikisht të saktë. Pas përmirësimit të dokumentacionit teknik dhe pas reflektimit të ndryshimeve, do të ri-tenderohet.

Pretendimet ankimore:

1. Autoriteti Kontraktues ka anuluar procedurën pas hapjes së ofertave dhe vlerësimit të tyre, duke pretenduar mospërputhje mes paramasës dhe projektit, ku sipas Nenit 62, paragrafi 2.2 i LPP-së, ndërprerja për shkak të ngjarjeve objektive duhet të bëhet të paktën 3 (tre) ditë para hapjes së tenderëve dhe se AK - Komuna Mitrovicë ka dështuar të vërtetojë se këto mospërputhje ishin të paparashikueshme në kohën e inicimit, duke qenë se vetë AK ka hartuar dosjen e tenderit.

Pra, AK - Komuna Mitrovicë e arsyeton anulimin si shkelje të ligjit që nuk mund të rregullohet në fazën pas hapjes së ofertave dhe pas vlerësimit të ofertave, madje duke shkelur edhe afatin ligjor të përcaktuar me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40.2 të Rregullores për Prokurim Publik, ku afati për vlerësimin e ofertave është gjithsej 30 ditë kalendarike dhe jo më tepër, ndërsa nga hapja e ofertave deri në njoftimin për anulimin e procedurës ky afat ligjor është shkelur nga AK.

Në këtë fazë të procedurës, çdo mangësi teknike në paramasë mund të adresohet përmes Nenit 71 të RRPP, i cili lejon ndryshimet në kontratë gjatë realizimit dhe se anulimi i tërësishëm i projektit pas 4 muajsh vlerësimi, me të gjitha këto shkelje ligjore, kur ekziston një OE i përgjegjshëm, siç është kompania jonë dhe brenda buxhetit dhe vlerës së përcaktuar, përbën shkelje të parimit të efikasitetit, sipas nenit 1 dhe 7 të LPP-së.

Pra, anulimi i procedurës në këtë fazë, kur kompania jonë është e vetmja përgjegjëse, siç është konstatuar edhe nga shumica e komisionit vlerësues, krijon dyshime të bazuara për diskriminim dhe subjektivizëm nga ana e njësisë Kërkuese, si hartuese e projektit.

2. Operatori Ekonomik nuk duhet të pësojë dëme apo kosto financiare dhe njerëzore të ofertimit për shkak të lëshimeve teknike të vetë Autoritetit Kontraktues, dhe ne si OE kemi ofruar tre amandamente të kontratave të mëparshme si prova (Prova 1, 2, 3) që dëshmojnë se ndryshimet teknike janë praktikë e rregullt dhe nuk kërkojnë anulim të procedurës.

Pra, procedura e prokurimit, gjegjësisht arsyetimi i tentimit për anulim, bie ndesh si tërësi me nenin 62 të LPP-së, nga paragrafi 2, ku përcaktohet qartë:

3. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit që nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës, vetëm për njëërën nga arsyet:
 - 2.1 Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; ose
 - 2.2 Para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku 3 (tre) ditë para hapjes së tenderëve.

Dispozitat ligjore janë të qarta. Pra, për këtë aktivitet të prokurimit, ne si OE jemi palë e interesit pasi jemi të përgjegjshëm dhe nuk e kemi tejkaluar buxhetin me çmim. AK nuk mund të anuloni dhe përfundoni procedurën e prokurimit pas rreth 4 muajsh pas hapjes së ofertave. Një gjë e tillë dhe arsyetimi i përshkruar nga ju si AK në njoftimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit, do duhej të ndodhte të paktën 3 ditë para hapjes së ofertave.

Ne si OE i plotësojmë të gjitha kërkesat kualifikuese, kemi ofruar validitet dhe sigurim të ofertës, kemi krijuar shpenzime financiare dhe njerëzore dhe ju si AK, në këtë fazë dhe me këtë arsyetim, nuk do duhej dhe nuk mund të anuloni procedurën e prokurimit në këtë fazë dhe me këtë arsyetim të anulimit.

Prandaj, kompania “Quality Asphalt” shpk - Ferizaj kërkon që OSHP të autorizojë ekspert shqyrtues të paanshëm, njohës të ligjit për prokurim publik dhe pretendimet tona ankimore të trajtohen në tërësi, ashtu siç përcaktohet me nenin 113 dhe 114 të LPP-së.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Dio Bes” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0105 kanë vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ekonomik ankues (DIO BES SH.P.K) i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues/ KUVENDI KOMUNAL MITROVICË, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat ligjor të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP).

Eksperti shqyrtues, gjatë shqyrtimit fillestar ka analizuar të gjitha shkresat e lendes dhe sqaron se operatori ekonomik ankues konform dispozitave të nenit 108/A të LPP-së, me datën 16.02.2026 ka dorëzuar kërkesën për Rishqyrtim pran autoritetit kontraktues , të cilën AK përmes vendimit të datës 19.02.2026 e ka refuzon kërkesën për Rishqyrtim si të pabazuar.

Eksperti shqyrtues, sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit është hera e dyte qe dorëzohet ankese në OSHP.

Fillimisht me datën: 25.07.2025, OE “Pro&Co Group SH.P.K.” ka parashtruar ankesë me nr.2025/690, kundër njoftimit për kontratë, ndërsa me datën 20.02.2026 OE ankues (DIO BES SH.P.K) parashtron ankesë ne OSHP, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-se të datës 10.02.2026, për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se dy anëtarët e komisionit vlerësues kanë konstatuar se OE ankues i plotëson kriteret e dosjes se tenderit, ndërsa njeri anëtar ka konstatuar se OE ankues nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit, nuk ka pasur votë unanime për përzgjedhjen e fituesit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pretendon se, sa i përket arsyes së anulimit të tenderit se nuk përputhen disa pozicione të paramasës me projektin, këto arsye dhe këto pretendime nga anëtari i komisionit në këtë fazë janë krejtësisht joprofesionale, kundërtëhënëse, subjektive, tendencioze e për me shume janë edhe jo ligjore, për shkak se asnjë projekt nuk mund te konsiderohet i “përsosur” gjatë përpilimit të tij, pra çdo projekt mund ti ketë edhe mangësitë e veta, megjithatë për çdo mangësi eventuale gjatë implementimit të kontratës ekziston mundësia ligjore që të revidohen ose amandamentohen projektet ne përputhje me rrethanat dhe ne harmoni te plote me legjislacionin për prokurim publik.

Lidhur me anulimin e aktivitetit te prokurimit, eksperti shqyrtues pasi ka analizuar dhe shqyrtuar gjithë dokumentacionin, sqaron se anulimi i aktivitetit të prokurimit nga autoriteti kontraktues është ne kundërshtim me Nenin 62 të LPP-së sepse nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e parapara me dispozitat e nenin 62 të LPP-së dhe njeherit autoriteti kontraktues, nuk ka dhënë asnjë arsyetim të qartë apo konkret se çfarë mospërputhje ka ne mes të projektit dhe paramases aq me tepër në këtë faze, ku detyre e komisionit vlerësues është që të vlerësoj dëshmitë e ofruara nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Prandaj, sqarimi i dhënë nga autoriteti kontraktues se “si rezultat i shqyrtimit teknik nga ana e njësisë se kërkesës dhe komisionit vlerësues, ekzistojnë mospërputhje ne mes të paramases dhe projekteve ekzistuese”, nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e OE “Quality Asphalt” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0022 kanë vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ekonomik ankues (" **Quality Asphalt** " SH.P.K.) i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues/ KUVENDI KOMUNAL MITROVICË, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat ligjor të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP).

Eksperti shqyrtues, sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit është hera e dyte qe dorëzohet ankese në OSHP.

Fillimisht me datën: 25.07.2025, OE “Pro&Co Group SH.P.K.” ka parashtruar ankesë me nr.2025/690, kundër njoftimit për kontratë, ndërsa me datën 20.02.2026 OE ankues (" **Quality Asphalt** " SH.P.K.) parashtron ankesë ne OSHP, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-se të datës 10.02.2026, për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pretendon se, sa i përket arsyes së anulimit të tenderit se nuk përputhen disa pozicione të paramasës me projektin, këto arsye dhe këto pretendime nga anëtari i komisionit në këtë fazë janë krejtësisht joprofesionale, kundërtënëse, subjektive, tendencioze e për me shume janë edhe jo ligjore, për shkak se asnjë projekt nuk mund te konsiderohet i “përsosur” gjatë përpilimit të tij, pra çdo projekt mund ti ketë edhe mangësitë e veta, megjithatë për çdo mangësi eventuale gjatë implementimit të kontratës ekziston mundësia ligjore që të revidohen ose amandamentohen projektet ne përputhje me rrethanat dhe ne harmoni te plote me legjislacionin për prokurim publik.

Lidhur me anulimin e aktivitetit te prokurimit, eksperti shqyrtues pasi ka analizuar dhe shqyrtuar gjithë dokumentacionin, sqaron se anulimi i aktivitetit te prokurimit nga autoriteti kontraktues është ne kundërshtim me Nenin 62 të LPP-së sepse nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e parapara me dispozitat e nenin 62 të LPP-së dhe njëherit autoriteti kontraktues, nuk ka dhënë ndonjë arsyetim te qartë apo konkret se çfarë mospërputhje ka ne mes te projektit dhe paramases aq me tepër ne këtë faze, ku detyre e komisionit vlerësues është qe te vlerësoj dëshmitë e ofruara nga operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

Prandaj, sqarimi i dhënë nga autoriteti kontraktues se “si rezultat i shqyrtimit teknik nga ana e njësisë se kërkesës dhe komisionit vlerësues, ekzistojnë mospërputhje ne mes të paramases dhe projekteve ekzistuese”, eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky arsyetim i AK-se.

-Seanca shqyrtuese-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e OE ankues; “Dio Bes” SH.P.K. & “Quality Asphalt” SH.P.K.

Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit.

Paneli Shqyrtues konsideron se konstatimi i ekspertit është i drejtë dhe i bazuar plotësisht në dispozita ligjore, ngase, anulimi i aktivitetit të prokurimit nga autoriteti kontraktues është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së sepse nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e parapara me dispozitat e nenin 62 të LPP-së dhe njeherit autoriteti kontraktues, nuk ka dhënë asnjë arsytim të qartë apo konkret se çfarë mospërputhje ka ne mes të projektit dhe paramases aq me tepër në këtë fazë, ku detyre e komisionit vlerësues është që të vlerësoj dëshmitë e ofruara nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Per me tepër anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit ne kete fazë është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43 .5 dhe 43.7 të RRPPNr.001/2022, pasi që nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita. Neni 43.5 i RRPP Nr.001/2022 i ka parashikuar kushtet që duhet të plotësohen për anulim, si më poshtë:

“43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a.asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;b.asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

c.numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se3(tre);

d.nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janëparaqitur brenda afatit të specifikuar;

e.numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pakse 3;

f.nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

g.asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;

h.nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;

i.një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmesnjë ndryshimi;

j.nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurënpërkatese dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose

k.nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë epaparashikuar dhe

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë të qëndrueshme ashtu siç janë dhënë në konstatimin e ekspertit dhe të këtij panelit.

Paneli Shqyrtues nga gjithë të gjeturat në këtë procedurë dhe në mbështetje të nenin 1 dhe 7 dhe dispozitave tjera ligjore të LPP-se të cituara në këtë vendimmarrje ka vendosur të anuloj B58 ‘Njoftim mbi vendimin e AK-se’, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull ‘Asfaltimi i rrugëve në Bajgorë, Rashan, Tërstenë, Kutillovc dhe Vllahi - Komuna e Mitrovicës së Jugut në Bashkëfinancim me MMPHI’ me numër të prokurimit 642-25-5633-5-1- dhe lëndën ta kthej në ri-vlerësim.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL MITROVICË, KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**
- **OE - Dio Bes SH.P.K., " Quality Asphalt " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: